



Universiteti Shtetëror i Tetovës Државен Универзитет во тетово State University of Tetova

Republika e Maqedonisë, 1200 Tetovë -Тетово, Rr.-ул.Илинденит-Илинденска Ректорати i Universitetit-Ректоратот на Универзитетот -
Republic of Macedonia, www.unite.edu.mk Tel: ++389 44 356 500 , Fax: ++389 44 334 222

Fjala përshëndetëse e Rektorit të USHT-së, prof. dr. Agron Reka

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,
-I nderuari Kryetar i Qeverisë, zotëri Nikolla Gruevski,
-I nderuari Nënkyetar i Qeverisë, zotëri Abdilaqim Ademi,
-I nderuari Ministër i Arsimit dhe Shkencës, zotëri Nikolla Todorov,
-E nderuara Zëvendësministre e Arsimit dhe Shkencës, zonjusha Lindita Qazimi,
-Të nderuar profesorë dhe studentë,

Zonja dhe zotërinj,

Universiteti Shtetëror i Tetovës, përgëzon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për promovimin e 13 titujve të librave që janë pjesë e përkthimit të 500 titujve profesional e shkencorë dhe librave të cilat janë tekste universitare, nga autorët më eminentë të universiteteve të njohura në SHBA dhe Evropë. Kësaj radhe Qeveria në USHT promovon tituj shkencorë dedikuar për Fakultetin Filozofik.

Përmes këtij projekti, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, universiteteve të vendit tonë u jep mundësi t'i pasurojnë fondet e bibliotekave të veta me 13 tituj të rinj, për nevojat e studentëve dhe për ta pasuruar fondin e përgjithshëm me vlera shkencore dhe kulturore, të cilat janë pjesë e rëndësishme e bashkësisë akademike në shoqëritë e shteteve më të përparuara të botës, si Shtetet e Bashkuara Amerikës dhe vendet e Evropës Perëndimore.

Me këtë rast, unë kam nderin në këtë promovim t'i përshëndes përfaqësuesit e lartë të Qeverisë, Kryeministrin, zotëri Nikolla Gruevski, Zëvendëskryeministrin, zotëri Abdilaqim Ademin, Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Zotëri Nikolla Todorov dhe Zëvendësministren, zonjushën Lindita Qazimi, stafin akademik dhe studentët, të cilëve edhe u dedikohet ky aktivitet.

Universiteti ynë e ka mirëpritur këtë projekt të rëndësishëm të Qeverisë dhe është përfshirë në mënyrë aktive në procesin e promovimit të tij. Veprimtaria botuese është një segment shumë i rëndësishëm në veprimtarinë tonë, dhe çdo vit ndajmë mjete të konsiderueshme për botimin librave, studimeve, monografive shkencore, revistave profesionale, për përkthime dhe furnizim me literaturë profesionale, në interes të studentëve dhe kuadrit mësimor.

I nderuari Zotëri Kryeministër,

Kuadri arsimor të cilin e ka sot, USHT-ja që janë shkolluar në gjuhën shqipe. Ky kuadër është fryti shkollimit të tyre jashtë vendit. Në këtë rrugë të gjatë të shkollimit të tyre ata kanë dhënë mund dhe investime të jashtëzakonshme dhe ata sot janë pedagogë të USHT-Së.



Universiteti Shtetëror i Tetovës Државен Универзитет во тетово State University of Tetova

Republika e Maqedonisë, 1200 Tetovë -Тетово, Рг.-ул.Илинденит-Илинденска Ректорати i Universitetit-Ректоратот на Универзитетот -
Republic of Macedonia, www.unite.edu.mk Tel: ++389 44 356 500 , Fax: ++389 44 334 222

Z. Kryeministër, Ju si autoritet i parë i Qeverisë të RM-së duhet të njiheni me gjendjen reale të USHT-së. Institucioni ynë sipëror po kalon zhvillimin e tij në situatë të rënda dhe atë për shkak të mosekzistimit të infrastrukturës fizike adekuate për zhvillimin normal të procesit mësimor.

I nderuari Z. Kryeministër,

Për të gjitha këto Ju nuk jeni fajtor, Sepse Maqedonia është vend i vogël, është vend në zhvillim e sipër, është vend që është ballafaquar me krizën ekonomike ashtu siç janë ballafaquar edhe shumë shtete të mëdha në Evropë dhe në Ballkan. Zhvillimi i një institucioni kaq të madh sikurse është ky i yni me 11 mijë studentë kërkon angazhimin tonë të gjithëve por në këtë moment tuajin në veçanti si autoritet i parë i Qeverisë së Maqedonisë të përdorni autoritetin Tuaj dhe ky institucion të ndihmohet të del nga kjo krizë infrastrukturore dhe ekonomike. Me këtë rast Ju shpreh mirënjohje të veçantë për kontributin tuaj dhe qeverisë për kontributin që keni dhënë për përfundimin e objektit të fakultetit të teknologjisë së ushqimit dhe të ushqyerit në Gostivar. Por kërkesa jonë më e madhe është që të përfundojë objekti i fakultetit Ekonomik dhe juridik në Tetovë.

I nderuari zoti Kryeministër,

Zyrtarizmi I UT-Së u bë në vitin akademik 2004. Por edhe pas zyrtarizmit të këtij Universiteti , ky Universitet nuk ka trajtim të njëjtë, pra të barabartë, si universitetet tjera shtetërore në Maqedoni.

Ja një shembull më të ri: USHT-ja nga buxheti I për vitin 2009 ka marr vetë 50 milion denar për investime kapitale, gjë që është 5 herë më pak në krahasim me vitin 2008 kur ka marr 250 milion denar. Me keqardhje mund të konstatojmë se me buxhetin për vitin 2010 gjendja do të jetë gjithashtu e keqe. Ndërtesa e fakultetit ekonomik dhe juridik, e cila ka filluar me ndërtim qysh në vitin akademik 2005/2006, nuk do të përfundojë me mjetet që janë paraparë me buxhetin për këtë vit një shumë prej 83 milion denarësh, shumë prej të cilës duhet të sigurohen hapësira, kushte pune, edhe për fakultetet e disperzuara në Republikën e Maqedonisë Nëse me rebalancin e buxhetit nuk rritet shumica e mjeteve për përfundimin e punëve të ndërtesës së fakultetit ekonomik dhe juridik, për të cilën nevojiten rreth 300 milion denarë, mësimi në USHT do të duhet zhvillohet në kushte jashtëzakonisht të pamundshme dhe për këtë njiheni personalisht që Z. Kryeministri do të keni edhe vetë mundësi ti shihni.

Shpresojmë se edhe në të ardhmen, Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të ndërmarrin aktivitete të këtilla në interes të përparimit të veprimtarisë arsimore, shkencore dhe kulturore në përgjithësi. Në fund, në emrin tim dhe në emër të Universitetit Shtetëror të Tetovës, të gjithëve Ju falënderoj për këtë aktivitet dhe mbetemi me shpresë se bashkëpunimi ynë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ju faleminderit!

Prof. dr. Agron Reka
Rektor i USHT-së